

70 fillime
procedurave
04/09/25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Nr. **13527** Prot.

Tiranë, më **28.08** 2025

Lënda: Kërkesë për marrje masash dhe fillimin e procedurave disiplinore ndaj Av. Kujtim Cakrani.

DHOMËS KOMBËTARË TË AVOKATISË
ADRESA: RRUGA ABDI TOPTANI, TIRANË

Të nderuar,

Bazuar në Ligjin Nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”, i ndryshuar dhe Ligji Nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”.

Sistemi i burgjeve në Republikën e Shqipërisë funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi, kryesisht Ligjin nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe të Paraburgosurve”. Ky sistem ka për qëllim ekzekutimin e vendimeve penale në mënyrë ligjore dhe humane, duke garantuar respektimin e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria dhe duke mbështetur procesin e rehabilitimit dhe riintegrit të tyre në shoqëri.

Duke iu referuar kompetencave tona ligjore dhe në zbatim të detyrës institucionale për administrimin e IEVP-ve dhe garantimin e rendit, sigurisë dhe ligjshmërisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ju paraqesim për shqyrtim rastin e mëposhtëm që, në vlerësimin tonë, përbën një sjellje të papranueshme nga ana e një përfaqësuesi ligjor, që bie në kundërshtim me etikën e profesionit dhe dispozitat që rregullojnë komunikimin e të paraburgosurve me publikun dhe median.

Në këtë kontekst, avokati, si subjekt i pavarur i sistemit të drejtësisë, luan një rol të pazëvendësueshëm në garantimin e të drejtave procedurale dhe materiale të personave të privuar nga liria. Në përputhje me Ligjin Nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ai ushtron funksione mbrojtëse, përfaqësuese dhe këshilluese, duke vepruar në interesin më të mirë të klientit dhe në përputhje me parimet e ligjshmërisë, konfidencialitetit dhe mbrojtjes efektive. Përmes ushtrimit të këtij funksioni, avokati kontribuon në sigurimin e një procesi të rregullt ligjor dhe në mbrojtjen efektive të lirive themelore të njeriut.

Masa e sigurimit personal “arrest në burg”, si një nga masat më të rënda të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale (nenet 238–243), vendoset me vendim të arsyetuar të gjykatës në rastet kur ekziston nevoja për sigurimin e të pandehurit gjatë hetimit apo gjykimin, parandalimin e arratisjes, përsëritjes së veprës penale ose ndikimit në prova dhe dëshmitarë. Ekzekutimi i kësaj mase realizohet nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit dhe konkretizohet me dërgimin e personit në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP), i përcaktuar për mbajtjen e të paraburgosurve.

Me akomodimin në institucionin penitenciar, personi që ndodhet nën masën e sigurimit “arrest në burg” fiton statusin e të paraburgosurit, i cili rregullohet nga dispozitat e posaçme të Ligjit nr. 81/2020 “Për të

Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe të Paraburgosurve”. Masa e sigurimit “arrest në burg” përmban kufizime specifike që lidhen me këtë status, duke përfshirë mënyrën e trajtimit, llojet e kontakteve dhe vizitave, si dhe rregullimin e komunikimeve, në përputhje me qëllimin e saj ligjor dhe nevojën për të garantuar procesin penal dhe rendin publik. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka përgjegjësinë për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të paraburgosurve, si dhe për ofrimin e kushteve të nevojshme për trajtim human dhe respektim të standardeve ligjore.

Ajo që vlen të theksohet është se në momentin kur personi ka fituar statusin e të paraburgosurit, çdo leje për realizimin e telefonatave, takimeve apo formave të tjera të komunikimit, duhet të miratohet paraprakisht nga prokurori, në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 49 të Ligjit nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe të Paraburgosurve”.

Përveç sigurimit të të drejtave, sistemi penitenciar është i angazhuar edhe në procesin e rehabilitimit, i cili synon përgatitjen e personit për rikthimin në shoqëri në mënyrë të suksesshme dhe pa përsëritje të veprës penale. Ky proces përfshin aktivitete edukative, trajnime profesionale, mbështetje psiko-sociale dhe përfshirje në programe të ndryshme sociale, që kanë për qëllim zhvillimin e aftësive dhe ndërtimin e një qëndrimi përgjegjës nga ana e personit të privuar nga liria.

Pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Jordan Misja”, Tiranë, ndodhet i akomoduar shtetasi Ilir Metaj, ndaj të cilit me vendimin Nr. 125, datë 20.10.2024 të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, është caktuar masa e sigurimit personal “arrest në burg”, në kuadër të një procesi penal në ngarkim të tij, i cili ka dhe përfaqësues ligjor Z. Kujtim Cakrani.

Më datë 1 korrik 2025, gjatë një emisioni televiziv të transmetuar drejtpërsëdrejti në televizionin “MCN”, ka qenë i ftuar avokati Kujtim Cakrani, i cili është prezantuar si mbrojtësi ligjor i shtetasit Ilir Metaj dhe me telefonin e tij ka realizuar një komunikim të drejtpërdrejtë audio me klientin e tij, i cili ndodhet në paraburgim. Sipas asaj që u transmetua publikisht, telefonin u vendos në altoparlant dhe më pas iu kalua moderatores për të realizuar një intervistë publike, duke shkelur qartazi kufizimet ligjore që lidhen me statusin e të paraburgosurit, i cili nuk gëzon liri të pakufizuar komunikimi, dhe sidomos jo me media apo publikun, pa miratim paraprak të prokurorit të çështjes. (linku ku mund të shikohet intervista <https://www.mentv.al/articles/feed/3d137335-f745-4dd7-85c6-a2f023cd4970>) (Linku youtube <https://youtu.be/wFqyRtpCpLg?si=eLGyAiFvNkNPEvMb>).

Në gjykimin tonë, veprimi në fjalë përbën një shkelje të rëndë të etikës profesionale, si dhe një cenim të drejtpërdrejtë të rregullave procedurale dhe të masës së sigurimit penal “arrest në burg”, pasi kjo masë sigurse kërkon një respektim të rreptë të kufizimeve të parashikuara nga ligji në lidhje me komunikimet publike dhe përfshirjen në media, me qëllim garantimin e integritetit të procesit penal dhe mbrojtjen e interesit publik.

Referuar Ligjit Nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton detyrimet që ka avokati dhe komunikimi i tij me të përfaqësuarin e tij është një e drejtë që i garantohet me ligj, por nga ana tjetër nuk mund t’u keqpërdorë këtë të drejtë për cënues figurën e strukturave të sistemit të burgjeve, si në rastin konkret. Për më tepër përveç cënimit dhe dëmtimit të figurës së sistemit të burgjeve, me veprimet e tij në kundërshtim me legjislacionin në fuqi ka keqpërdorur atributet që i jep statusi i avokatit dhe nga ana tjetër ka dëmtuar edhe interesat e të klientit të tij, pasi ky i fundit i është nënshtruar procedurave disiplinore nga insitucioni ku ndodhet i akomoduar aktualisht.

Pasi referuar nenit 8/2 të Ligjit Nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve” institucioni ka të drejtë të marrë masa të përkohshme për të parandaluar dhe verifikuar çdo rast të dyshuar që cënon rregullin, sigurinë ose përdorimin jo të duhur të të drejtave të parashikuara, pasi një ngjarje e tillë cënon institucionin e IEVP Jordan Misja, duke sjellë pasojat si më poshtë:

- Vendos stafin në pozitë të vështirë për të justifikuar ngjarjen.
- Dëmton reputacionin profesional të punonjësve të sigurisë.
- Kompromenton sistemin e monitorimit të bisedave.
- Rrit barrën hetimore mbi institucionin për incidente të ngjashme.
- Rrezikon masë disiplinore ndaj stafit pa faj konkret.
- Krijon perceptim se rregullorja nuk zbatohet njësoj për të gjithë.
- Përdoret politikisht kundër institucionit të vuajtjes së dënimit.
- Krijohet perceptim se sistemi i burgjeve është i dobët për kontrollin e komunikimeve.
- I jep sinjal të paraburgosurve të tjerë se mund të komunikojnë pa leje.
- Nxit precedent ku të paraburgosurit përdorin persona të tretë për komunikime.

Për rastin konkret Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rithekson se nuk ka dhënë asnjë autorizim për realizimin e komunikimit në fjalë. Veprimi i ndërmarrë përbën një ndërhyrje të papranueshme në funksionimin normal të IEVP dhe cenon rëndë rendin dhe autoritetin e institucionit të paraburgimit. Pra, krijon një precedent të rrezikshëm, duke shkelur në mënyrë të hapur dispozitat e nenit 49, të ligjit nr. 81/2020 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”, dhe normat që rregullojnë ushtrimin e detyrës së avokatit me integritet, etikë dhe përgjegjësi.

Veprimi i avokatit z. Kujtim Cakrani përbën tejkalim të rolit të tij si përfaqësues ligjor, duke mundësuar një komunikim publik përmes një procedure jashtë kuadrit formal të miratimeve institucionale. Ai ka anashkaluar procedurat ligjore të kërkimit të miratimit nga organet përkatëse, duke e vendosur institucionin e paraburgimit përpara një fakti të kryer në mënyrë arbitrare dhe të paautorizuar. Kjo sjellje cenon rëndë rendin dhe sigurinë në sistemin penitenciar dhe parimin e barazisë përpara ligjit për të gjithë të paraburgosurit.

Për këto arsye, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në referim të nenit 39 dhe neni 40 të Ligjit Nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” kërkon nisjen e një procedure disiplinore ndaj avokatit z. Kujtim Cakrani. Pas vlerësimit dhe trajtimit nga ana juaj, kërkojmë të na informoni lidhur me vendimarrjen dhe masën e dhënë ndaj avokat z. Kujtim Cakrani.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë në shtojcën 1, transkriptin e bisedës së zhvilluar në emision. (11 fletë)

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

KLEVIS QOSE



Shtojca 1

TRANSKRIPTI I BISEDËS SË ZHVILLUAR MË DATË 01.07.2025 NË STUDIO E MCN TV MES GAZETARES, AVOKATIT KUJTIM CAKRANI DHE SHTETASIT ILIR META.

Avokati Kujtim Cakrani: Po.

Ilir Meta: Po, ju dëgjoj shumë mirë.

Avokati Kujtim Cakrani: Jam në studio, President.

Ilir Meta: A ka ndonjë pyetje për mua direkt?

Avokati Kujtim Cakrani (duke iu drejtuar gazetares): E ka për juve, do t'i përgjigjesh?

Gazetarja: Po, zoti Meta, të përshëndes. Jemi në transmetim të drejtpërdrejtë. Besoj se na ndjek me aq mundësi sa keni.

Ilir Meta: Po, ju ndoqa. Dhe ju ndoqa shumë tek ajo punë e asaj karte. Më pëlqeu shumë ajo pyetja juaj e thjeshtë. Mund të ma bëni mua direkt?

Gazetarja: Atëherë, jo, nuk është se kam interes personal. Le të sqarojmë këtë: unë nuk kam interes personal, por përpiqemi me avokatin.

Ilir Meta: Jo, jo. Ju keni interes për publikun, nuk është problem për personal, se s'është.

Gazetarja: Atëherë, si është historia e kartës që në media na u servir si një fshehje e blerjeve që ju mund të keni bërë?

Ilir Meta: Atëherë, mund t'ju jap këtë sqarim?

Gazetarja: Patjetër, të lutem.

Ilir Meta: Po. Së pari, unë nuk e di se sa ka trashëguar zonja Kryemadhi, sepse – siç e tha edhe avokati – ajo ka pasur shumë pasuri për shkak të një pallati bashkë me nënën e saj, etj., të cilat janë të deklaruara dhe të ligjshme. Së dyti, unë në jetën time kurrë s'kam pasur kartë, edhe për shkak të pozicioneve që kam pasur. E vetmja kartë që unë kam marrë ka qenë tek banka Credins, katër ditë para se të më rrëmbeinin, siç e keni parë ju. Së treti, duhet të keni parasysh se kartat që pretendon SPAK-u janë karta ekskluzive sipas vetë SPAK-ut, të cilat janë për zonjën Kryemadhi dhe nuk kanë asnjë lidhje me zotin Meta. Po kështu, vendet ku SPAK-u pretendon se janë bërë shpenzime me këto karta janë vende ku unë as kam qenë ndonjëherë, as kam plan të shkoj. Las Vegas, etj., që njihen shumë, por unë nuk jam njeri i kazinove apo i këtyre gjërave luksoze. Mua më pëlqen Prevala, më pëlqen Qereti, Dobërdoli – domethënë jam më i lidhur me natyrën. Kështu që ato nuk kanë asnjë lidhje me mua, as kam pasur kurrë dijeni. Uroj të mos jenë të vërteta, sepse, nëse janë të vërteta, padyshim që janë shumë të papranueshme dhe të rënda për një politikane me përvojë, e cila gjithmonë ka qenë e këshilluar prej meje të jetë shumë e kujdesshme me ligjin. Aq më tepër që këtë gjë duhet ta kishte dhe vetë, se është ligjvënëse prej njëzet vitesh.

Gazetarja: Po ju rëndon Monika Kryemadhi, po thoni?

Ilir Meta: Pra, nuk ka asnjë lidhje karta tek unë. Këto janë të gjitha aludime që shpërndahen qëllimisht nga gazetarët e SPAK-ut, më fal që po e them kështu.

Gazetarja: Të lutem, po.

Ilir Meta: Kjo ishte edhe një prej tyre. Edhe tek ju, para ca kohësh, thoshte: “Ka probleme psikiatrike zoti Meta.” Unë jam si kokrra e mollës. Edhe po të doni, merrni një leje ju dhe ajo, dhe hajdeni më bëni një intervistë këtu.

Gazetarja: Jo, jo. Unë maksimumi të pres në studio, por kjo s’lejohej.

Ilir Meta: Po, pikërisht. Unë jam këtu që të mos jem në studio, që për mua të thuash shpifje, siç ishte shpifja mbi të cilën u rrëmbeva – që gjoja jam paguar një milion euro apo dollarë, etj., me një kompani Megon Fidesis, nëse ju e keni dëgjuar.

Gazetarja: Po, po.

Ilir Meta: E cila rezultoi nga vetë SPAK-u: pesëmbëdhjetë mijë dollarë të deklaruar me vendim kryesie, siç merreshin vendimet në kohën time, që çdo gjë bëhej transparente në Kryesinë e partisë sonë. Tani, meqë jemi tek lobimet, të sqaroj edhe një çështje tjetër.

Gazetarja: Po, të lutem.

Ilir Meta: Që nuk e sqaron SPAK-u qëllimisht, dhe që mund t’jua sqarojë edhe avokati juve aty, që ne ia kërkuam.

Gazetarja: Po, por s’po e lejoj avokatin të ndërhyjë, duke qenë se minutat mund t’i keni të kufizuara. Po hesht, që të merrni ju vëmendje.

Ilir Meta: Ia kërkuam edhe në seancën e gjykimit prokurorit të çështjes, e cila ka tre vjet që zvarritet. Ai pretendon për një kompani e cila ka pasur një kontratë të ligjshme me Lëvizjen Socialiste për Integrim, të firmosur nga një titullar i kësaj partie, jo nga unë.

Gazetarja: Po.

Ilir Meta: Edhe pretendon që ajo kompani i ka faturuar LSI-së në fund të vitit 2017, kur unë s’kam qenë kryetari i saj, kam qenë President i Republikës. Por kjo nuk ka rëndësi. I ka faturuar një shumë shumë të madhe, e cila nuk përputhet me shumat që janë depozituar në KQZ sipas ligjit nga kjo parti. Tani, qëllimisht mendoj unë, sepse ne kemi dy vjet që kemi qenë tek SPAK-u për këto çështje, apo jemi pyetur nga SPAK-u, dhe SPAK-u nuk na thotë kujt personi në LSI kjo kompani i ka çuar faturat. Sepse ky është personi kyç.

Gazetarja: A na e thoni ju, zoti Meta?

Ilir Meta: Jo, po unë s’kam ç’t’ju them, se unë nuk kam qenë dhe nuk e di, e para. Dhe e dyta, po ta dija, nuk e kisha lejuar kurrë një veprim të tillë, sepse nuk mund të lejoheshin veprime në kundërshtim me ligjet shqiptare apo edhe me ligjet amerikane. Aq më tepër që ne e dinim historinë e gruas së Bilalit, apo jo?

Gazetarja: Pra, ka tradhtarë brenda LSI-së së atëhershme, që sot janë në kushte të favorshme?

Ilir Meta: Tani, mund të më dëgjoni me vëmendje, edhe ju edhe publiku.

Gazetarja: Dakord, dakord, po.

Ilir Meta: Në rast se ky pretendim që ngre SPAK-u është i vërtetë, pra që janë bërë pagesa për llogari të LSI-së tek kjo kompani, apo tek ndonjë kompani tjetër – nuk ka rëndësi – të cilat nuk janë raportuar në KQZ, dhe të cilat nuk janë miratuar në Kryesinë e partisë së LSI-së (e cila kishte statutin e vet dhe merreshin vendimet për shpenzimet), pa dyshim që kemi të bëjmë me veprime të paligjshme. Pa dyshim që kemi të bëjmë me vepra penale. Dhe pa dyshim që ata që i kanë bërë këto vepra, në vlerësimin tim, janë pikërisht ata që edhe mbrohen, duke mos na i dhënë faktet e plota. Sepse duhet dhënë fakti: kujt i kanë shkuar këto para, kujt ia kanë çuar këto fatura. Se dikujt ia çonin faturat, sepse historia e lobimit është kjo: ti bën marrëveshje me një kompani...

Gazetarja: Po.

Ilir Meta: ...ti cakton një person që e firmos, kjo depozitohet në KQZ, depozitohet edhe në Departamentin e Drejtësisë në Amerikë. Dhe njëkohësisht, një person i ngarkuar e zbaton, pra klauzolë për klauzolë. Sepse nuk merret kryetari i partisë – të themi – që: “erdhi ky, ka qenë në këtë hotel, u pagua kjo gjë, u pagua ajo gjë.” Jo, këto i kanë persona të tjerë. Pra, ka persona përgjegjës. Dhe SPAK-u, në vlerësimin tim, na e fsheh qëllimisht. Sepse janë bërë tre vite, e kuptoni? Nuk është se filloi kjo punë tre javë. Kujt ia ka faturuar kjo kompani, apo çdo kompani tjetër, kujt ia ka çuar faturat? Një personi ia ka çuar, se nuk mund t’ua çojë tridhjetë mijë anëtarëve të LSI-së. Kujt ia ka çuar? Këtë gjë SPAK-u na e fsheh. Pse na e fsheh? Cila është arsyeja? Për të na mbajtur në ajër, më kuptoni? Edhe në tymb, apo jo? Idëja që duhet të jetë Ilir Meta, etj. Etj. Gjë që është njëqind për qind e pavërtetë. Ashtu siç rezultoi çështja “MCON” – që ishte njëqind për qind, siç e kam thënë unë para tre vjetësh. Ashtu është edhe kjo. Ashtu janë të gjitha në raport me mua. Por atyre nuk u intereson të merren me të tjerët, me shkelësit e ligjit, sepse ata i bëjnë bashkëpunëtorë, i përdorin për diversion. Unë prandaj e kam goditur SPAK-un si instrument politik. Se unë s’kam qenë kundër hetimit.

Gazetarja: Po, tani të bëj një pyetje?

Ilir Meta: Se unë s’kam qenë kundër hetimit. Unë jam për hetimin. Por përgjegjësitë janë individuale.

Gazetarja: E kuptova këtë. Të bëj një pyetje, zoti Meta?

Ilir Meta: Po, po, po.

Gazetarja: Ne kemi diskutuar herë pas here: qenien tuaj në burg, apo nëse duhej të kishit një masë më lehtësuese. Edhe të ftuarit në studio...

Ilir Meta: Pse duhet të jem në burg unë? Kam një pyetje për juve!

Gazetarja: Jo, jo, po ja pra. Këtë po them: a është fakti që ju keni përdorur një gjuhë të ashpër, duke i rënë edhe tavolinës, e duke bërë presion, që ju sot jeni pas hekurave?

Ilir Meta: Kujt? Kujt i kam bërë presion unë?

Gazetarja: SPAK-ut, mo, SPAK-ut.

Ilir Meta: Po, kur ia kam bërë këtë presion?

Gazetarja: Përpara se të ndodhte ngjarja e rrëmbimit.

Ilir Meta: Po, më fal, më fal, kur?

Gazetarja: Në çdo dalje, Ilir Meta, ju keni qenë një nga personat që keni përdorur...

Ilir Meta: Dëgjo, ju keni aty avokatin, më falni.

Gazetarja: Ehë...

Ilir Meta: Edhe avokati jua sqaron shumë mirë në cilat raste përdoret kjo metodë e izolimit të eksperiencës.

Gazetarja: Jam dakord, por a mendoni se kjo ka ardhur si pasojë e gjuhës tuaj?

Ilir Meta: Më fal, më fal, më fal. Jo, jo, jo. Gjuhën e ashpër do ta sqaroj unë. Ajo tregon që unë kam pasur shumë për të thënë. Dhe kam qenë shumë i butë. Më dëgjo me vëmendje, të lutem. Çfarë rreziku kam unë të prish prova? Për çfarë? Për çështjen e "DIAS"-it?

Gazetarja: Jo, zero.

Ilir Meta: Më fal, po cilat dosje? Se ajo ka gjashtëmbëdhjetë vjet dhe është gjykuar. Është gjykuar në gjykatat e Shqipërisë.

Gazetarja: Po, prandaj doli edhe kjo.

Ilir Meta: Më fal, më fal, të lutem. Është gjykuar edhe në arbitrazh në Vjenë. Unë s'kam asnjë lidhje. Ata duan të mbajnë atë. Dhe ka edhe Dumani, që – të vijmë tek thelbi i pyetjes suaj – e ka nisur këtë çështje që në dhjetor 2019. Dhe më thoni ju mua: nga dhjetori 2019, dhe ka bërë edhe veprime hetimore të cilat, në vlerësimin tim, nuk kanë qenë të ligjshme – por s'ka rëndësi – nga dhjetori 2019 deri në prag të konventës së Partisë së Lirisë, pra fundi i marsit, prillit, etj... Unë nuk e kam sulmuar zotin Dumani. Unë mund të kem folur për SPAK-un për punën e inceneratorëve. Dhe kam folur me shumë të drejtë, që nuk i shikonte...

Gazetarja: Kjo është tjetër...

Ilir Meta: Jo, jo, më fal, më fal, po. Unë kam kundërshtuar publikisht, dhe duhet ta kundërshtoni edhe ju atë që ai e ka thënë publikisht: që SPAK-u vendos mbi gjykatën, që gjykata të vendosë çfarë kërkon SPAK-u. Se kjo është një shkatërrim për një vend demokratik.

Gazetarja: A e ka marrë SPAK-u si kërcënim gjuhën tuaj, jo denoncimet? Se denoncimet janë ligjore.

Ilir Meta: Më fal, më fal, jo, të lutem, të lutem. Nuk ka lidhje kjo me këtë çështje. Unë jam politikan.

Gazetarja: Patjetër, nivelet më të larta.

Ilir Meta: Në qoftë se SPAK-u... më fal... në qoftë se unë shikoj që SPAK-u përdor disa celularë të disa personave që i kap në Partinë e Lirisë, dhe që i kap me probleme, për t'i përdorur kundër Partisë së Lirisë, për të marrë vulën e Partisë së Lirisë – sigurisht që unë do mbaj qëndrimin tim. Sepse unë do mbroj demokracinë. Sepse ai nuk është më një instrument që heton apo që lufton për drejtësi, por është një instrument që po përdoret për të gjymtuar pluralizmin politik. Gjë që është edhe rasti i zotit Berisha. Që jua shpjegoi shumë mirë juve avokati: pse do arrestohet Berisha? Pse do futej në arrest shtëpie Berisha? Çfarë kishte bërë Berisha? Çfarë prove do prishte Berisha, apo jo? Pastaj, mos kalojmë tani tek Rama. Se ne, kur flasim për Ramën, nuk flasim për përgjegjësi politike, ne flasim për përgjegjësi individuale. Sepse Rama ka edhe firmën, që është shpallur kompania fituese. Ka marrë bonusin pa u krijuar, pa lindur fare. Kjo është përgjegjësi individuale. E para. E dyta...

Gazetarja: Po.

Ilir Meta: Ne nuk po gjykojmë Ramën thjesht për gjëra kolektive, por ne po e gjykojmë Ramën sepse drejtori i prokurimeve i ka bërë Ramës me shkrim, Engjëll Agacit, për ato shtatëmbëdhjetë vendime të famshme, që këto janë të paligjshme. E ka shkresën atje SPAK-u. Pra, ai është paralajmëruar për këtë gjë. Nuk është se pyeti për atë që s'kishte dijeni, nuk është jurist. Kështu që të gjitha këto tregojnë standarde jo vetëm të dyfishta të SPAK-ut, por që po përdoret si një instrument vërtet shumë politik, policinesk. Edhe këtu është një situatë shumë e rëndë.

Gazetarja: Sa minuta ke në dispozicion, zoti Meta? Se dua të bëj edhe një pyetje.

Ilir Meta: Bëni pyetje sa të doni.

Gazetarja: Jo, se s'dua të penalizohesh nga unë. Jam duke folur, dua të sqaroj diçka, dhe ky është telefoni.

Ilir Meta: Për gazetarët le të penalizohem, s'ka asnjë problem.

Gazetarja: Po, jo, se s'na vjen mirë për këtë, për hir të së vërtetës.

Ilir Meta: Bëj shumë pyetje, pa asnjë problem.

Gazetarja: Eh, jo... je bërë pishman për këtë retorikë? Unë aty do të qëndroj pak. Ke reflektuar?

Ilir Meta: Jooo fare. Retorika ka qenë shumë e butë. Sepse kjo tregon shumë qartë se SPAK-u është kthyer në një instrument për shkatërrimin e demokracisë. Sepse i ka kërkuar mandat të hapur që nuk i takon. Ne kemi bërë reformën me 140 vota, dhe reforma e ka pasur të qartë që këta e kanë mandatin nëntëvjeçar. Pastaj kalojnë atje ku kanë qenë, brenda sistemit, se nuk i lë njeri në rrugë këta, apo jo? Këta thonë: "Ne do rrijmë edhe njëqind vjet." Kam një pyetje për ju?

Gazetarja: Po, të lutem, po.

Ilir Meta: A u shty hetimi për herë të katërt për Arben Ahmetajn? Për ta çuar çështjen për gjykim?

Gazetarja: E çfarë do të thotë kjo?

Ilir Meta: Më fal, akoma s'kanë provat e mjaftueshme? Pse donin ta arrestonin Arben Ahmetajn para dy vjetësh? Kam një pyetje: çfarë rreziku shoqëror përbënte Arben Ahmetaj? Ishte deputet,

ishte figurë publike. Kë do vriste, kë do plagoste, apo jo? Pra, këtu kemi të bëjmë qartë: SPAK-u është totalisht pararojë e Edi Ramës për të çimentuar pandëshkueshmërinë e tij, për të shkatërruar pluralizmin politik, për të marrë peng të gjithë kundërshtarët e tij. Dhe pa dyshim që standardet e hetimit tim janë si standardet e rrëmbimit tim: të të vijnë banditë në makinë, pa asnjë letër as nga policia, as nga askush, as nuk thonë se kush janë e çfarë janë. Ulërima, automatikë... dhe të fusin në makina private.

Gazetarja: Zoti Meta, tani atë e kuptoj unë, po a keni... më lër t'ju pyes kështu, sikur jam drejtpërdrejt, edhe pse s'ju kam intervistuar më herët: a keni dhe ju faj për mënyrën se si nuk i menaxhuat nervat? Ka akuza që jeni sjellë shumë keq, ndërkohë që ju keni qenë në nivelet më të larta. Presupozohet që ju duhet të kishit menaxhuar kriza të mëdha. Keni sharë, keni fyer në momentin e arrestimit apo ndalimit.

Ilir Meta: Kë kam sharë unë? Kë kam sharë?

Gazetarja: A ju kanë lënë nervat në ato momente, zoti Meta?

Ilir Meta: A? Jo, jo! Nga nervat? Unë jam shumë i qetë. Kë kam sharë unë?

Gazetarja: Po, sqarojeni, se unë s'kam qenë aty ku ta shikoj. Sqarojeni për opinionin publik.

Ilir Meta: Epo jo, jo... Unë kam një pyetje për ju.

Gazetarja: Po.

Ilir Meta: Ju, ku e dëgjuat që shava unë?

Gazetarja: Pra, atëherë ka zëra...

Ilir Meta: Ka rregulla se si mund të ndalohet një person, më kuptoni?

Gazetarja: Ke shumë të drejtë, dhe unë nuk po diskutoj për anën njerëzore. Se po të jem unë, lejohet të reagoj ashtu. Por ju, si politikan i këtij kalibri, a mundet ta kishit minimizuar atë individin që ka gabuar përballë, duke treguar ç'është realisht Ilir Meta? Apo ju kanë lënë nervat në ato momente dhe i keni dhënë shkas?

Ilir Meta: Jo moj ti zonjë e nderuar, nervat i ka lënë një shtet që është kthyer mbrapsht. Sepse, e para njëherë, unë po kthehesha nga Kosova. E dyta, unë kisha bërë postimin që do të shkoja në seli për konferencë shtypi.

Gazetarja: Po, keni shkuar në SPAK sa herë që ju kanë thirrur, nuk keni bërë rezistencë.

Ilir Meta: Të lutem, të lutem. Jo, jo! Nervat i kanë lënë ata. Marrin, fusin 15–20 banditë me maska që janë jashtë ligjit. Janë jashtë ligjit ata, se ata janë forcat speciale kundër terrorizmit etj.

Gazetarja: Po, po.

Ilir Meta: Që kanë terrorizuar edhe njerëz të tjerë para meje. Sepse ajo që keni parë ju është fundi.

Gazetarja: Kuptoj.

Ilir Meta: Ata kanë pasur një dhjetë minuta para, që ta shikonit ju, kur ishte bllokuar trafiku, hynin makina të tjera kot, sikur po kërkonin dikë. Ishte një shfaqje e organizuar prej kohësh. Dhe unë nuk kam bërë asnjë fyerje, asgjë. Ata dokumentojnë. Por, në këto momente, gjithmonë ai që bën ndalimin duhet të nxjerrë një letër. Të nxjerrë letrën e prokurorit apo letrën e policisë. Të thotë se kush është. A e patë ju arrestimin e Erion Veliajt? E patë?

Gazetarja: Po, po, sigurisht, me detaje.

Ilir Meta: Po, ai ishte arrestim model. Pse arrestimi im duhej të bëhej në ato mënyra? Pse? Për të më trembur mua? Mua ata nuk më trembin dot. Për të trembur shqiptarët, po. Për t'i tmerruar, për t'u thënë: "Kush thotë gjëra të vërteta, përfundon kështu." Pra, janë këta që keqpërdorin pozitën zyrtare për të fshehur gjëra të vërteta. Pse, çfarë kam thënë unë? E para, kritikën e mia ndaj SPAK-ut, ose ndaj reformës, nisën që në janar 2017. Atëherë kur unë isha kryetar Parlamenti. Janë hedhur goglat në Kuvendin e Shqipërisë për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Emërimeve në Drejtësi. U bë një proces shembullor me përfaqësues të EURALIUS-it, me përfaqësues të OPDAT-it. Dhe, mbasi nuk i pëlqyen emrat Edi Ramës, nxori ambasadorin Lu një ditë më pas, i cili i futi një gënjeshtër kot, për të prishur procesin. Edhe kështu u prish procesi për vite të tëra. Ngeli vendi pa Gjykatë Kushtetuese, pa Gjykatë të Lartë... e ku di unë. Kështu që, unë këtë luftë nuk e bëj për vete. Se unë këtë luftë e kam të fituar. Unë këtë luftë e bëj për mijëra shqiptarë që janë në paraburgim prej një viti, dy vitesh, që nuk i pyet njeri. Që s'kanë mundësi të shkojnë në Strasburg, që s'kanë mundësi të kenë një avokat të shkëlqyer si zoti Cakrani, apo zoti Gjokutaj, e ku di unë. Ata janë për statistika. Ndërkohë që inceneratori vazhdon e punon, Dumani nuk e sheh, dhe po kështu të gjitha ato PPP-të dhe të gjitha aferat e tjera. Ky është problemi.

Gazetarja: E kuptoj.

Ilir Meta: Kështu që nuk është problemi sepse... një ditë do të thonë: nuk hynë banditët tek makina ku ishte Meta, por shkoi Meta dhe hyri tek makina ku ishin banditët e shtetit.

Gazetarja: Jo, jo, kur unë e thashë këtë, e kisha edhe si perceptim si qytetare dhe si gazetare, që mund...

Ilir Meta: Unë nuk godita njeri. Unë nuk mund të ikja si nuse, apo jo? Si thua ti?

Gazetarja: Jo, unë besoj, unë besoj... duke ju njohur.

Ilir Meta: Ata pse e bënë? Ata pse e bënë? E dyta, ku e dija unë që ishin njerëz të shtetit? Ata, ku e dija unë? Ata s'kishin asnjë gjë. S'kishin. E para, e dyta: sjellja e tyre nuk ishte sjellje shtetërore, ishte sjellje kriminale. A e dini ju që kështu e kanë rrëmbyer Aldo Moron? Brigada terroriste në Itali? Kështu e kanë rrëmbyer.

Gazetarja: E kuptoj se ç'po thua.

Ilir Meta: Kështu e kanë rrëmbyer, si thoni ju? Kur një bandit kërkon të të rrëmbejë, ti do t'i thuash: "Hajde, faleminderit që po më rrëmben?"

Gazetarja: Unë mendoj se një politikan i kalibrit tuaj ka mjete dhe mekanizma për të çarmatosur këdo që i del përballë. Por, gjithsesi, ju e keni gjykuar ashtu.

Ilir Meta: Si? Po mirë, ne tani flasim me logjikë. Po ata të çarmatosur janë, se gjithë opinioni i ka parë se çfarë banditësh janë. Edhe ajo është një vepër e përbashkët e Edi Ramës, e Altin Dumanit dhe e McGonigal-it. McGonigal-i është ai zëdhënësi anonim.

Gazetarja: Kishit ju sinjale, zoti Meta, që mund të gjendeshit në këtë situatë, që justifikon edhe sulmet herë pas here që bënit së fundmi? A ju shkonte mendja që do të përfundonit në burg, dhe në këtë mënyrë demonstrative?

Ilir Meta: Po jo, moj, unë s'kam përfunduar në burg. Unë jam i lirë. Në burg jeni ju tani... më vjen keq. Se ju jeni e lirë "në atë". E dyta, unë s'kam qenë kurrë ndonjëherë. E treta, unë kam një vit e gjysmë para se të më rrëmbenin që përditë, nga koleget tuaja, Lala, Llabani, të gjithë ç'keni andej që rrinë pranë SPAK-ut, përditë thoshin: "Arrestohet sot, arrestohet nesër." Një tjetër thoshte se është arratisur.

Gazetarja: Epo, këtë skenarin e arratisjes e keni menduar, se e keni thënë. Po unë do ta pyes, e kam të qartë, e di shumë mirë se ç'keni deklaruar.

Ilir Meta: Më fal, po unë të arratisem nga këta? Unë të arratisem nga këta legena? Po pse? Njeriu arratiset kur bën një krim. Po nuk arratiset njeriu pse mbron Shqipërinë, pse mbron Kosovën, pse mbron detin e Shqipërisë. Për këto arratiset njeriu? Për çfarë do të arratisem unë? E para. E dyta, mua ma kanë hequr imunitetin që në moshën 22 vjeç, që në shtator 1992. Dhe donin të më arrestonin. Një prokuror dha dorëheqjen, dhe për këtë arsye Maks Haxhia nuk e pranoi, kishte dhe arsye të tjera ai, që të firmoste për arrestimin tim. Ç'është ky muhabet, që do të arratisem unë?

Gazetarja: Zoti Meta, ashtu si duket, keni menduar, keni pasur kohë, besoj. Janë ditë ndryshe ato. A e pranoni rikthimin tuaj në jetën publike? Keni një ide në kokë se si mund të jetë, pasi ta fitoni këtë betejë?

Ilir Meta: Është e padiskutueshme. Kjo është e padiskutueshme.

Gazetarja: Unë prandaj ju pyes, sepse kam një ide për politikanin që jeni ju.

Ilir Meta: Më dëgjo, kjo është çështje durimi. Duhet durim strategjik. Kjo është një betejë e fituar, sepse është një betejë që ne kemi të vërtetën me vete. Kuptohet, ata kanë shumë mjete me vete, sepse gjithë ato para të inceneratorit, kuptohet edhe si shpërndahen nëpër media. Kuptohet, edhe ato para të PPP-ve, se si shpërndahen e se si bëhen, etj. Përdoret drejtësia për të kapur njerëz të cilët kanë bërë shkelje, për t'i marrë e rrëmbyer, për t'i kaluar në kampin e mazhorancës, për të plotësuar opozitën. Të gjitha këto i dimë. Por, ne kemi të vërtetën. Dhe duke pasur të vërtetën, jemi shumë të fortë. Duke pasur karakterin e fortë, jemi akoma më të fuqishëm. Duke pasur traditat patriotike brez pas brezi, jemi të pathyeshëm. Kështu që mos kini merak, ne do ta fitojmë këtë betejë. Është çështje kohe, pa asnjë diskutim. Dhe një gjë tjetër, mos e harroni: unë i takoj atij brezi i cili mori pjesë në përmbyshjen më të madhe, që nuk mendohej në Shqipëri, që ishte ajo e dhjetorit. Dhe unë isha një nga ata studentë e pedagogë në atë takim historik me Ramiz Alia, kur pranoi pluralizmin... Edhe ne nuk e dinim kur hipëm në autobus se ku po shkonim: po shkonim tek

Ramizi, apo po shkonim në një vend tjetër? Dhe unë nuk isha nga ata që nuk kishin se çfarë të humbnin, se nuk kisha qenë i persekutuar si zoti Cakrani që keni aty ju, apo si shokët e tjerë. Unë kisha një pozitë shumë të mirë personale, isha një student shumë i preferuar në Fakultetin e Ekonomisë, me shumë perspektivë. Kisha prindërit me pozita shumë të mira, edhe motrën në një punë shumë të mirë në agro-eksport, etj. Pra, kishim më shumë për të humbur. Por, në këto raste nuk shkohet pas interesit, shkohet pas së vërtetës, pas të drejtës dhe pas asaj që vjen. Sepse të gjithë jetojmë nën të njëjtin qiell, por nuk shohim të njëjtin horizont – duhet të shohim pak më larg. Mua më vjen keq që ne kemi sot prokurorë dhe gjyqtarë fare pa dinjitet. Unë nuk kam asgjë kundër prokurorëve, nuk kam asgjë kundër gjyqtarëve, absolutisht. Kam qenë gjithmonë në krah të tyre. Por, po qe se dikush përdoret politikisht, atëherë profesioni i tij bie. Politika është detyrë tjetër, drejtësia është të zbatosh ligjin. Sepse mua politikisht nuk më mund dot njeri.

Gazetarja: Zoti Meta, ndiheni ju i tradhtuar nga miqtë në këto situata? Se kjo është histori shqiptare – të mos shkosh në buzë të greminës, se të tutë të japin shtysën e fundit.

Ilir Meta: Dëgjo, kjo përpjekja për ta prezantuar sikur unë e kam nga bashkëpunëtorët, kjo është e pavërtetë.

Gazetarja: Jo, nuk e kisha nga kjo. E kisha sot.

Ilir Meta: Jo, jo, më fal. Kjo është një lojë e regjimit. Më fal, unë bile këtë nuk e kam as nga Edi Rama, që ta dish. Edi Rama është një vegël qorre që e përdorin, siç janë përdorur gjithmonë njerëz të tillë. Kanë gjetur gjithmonë njerëz me probleme, njerëz të kapur, njerëz të shantazhueshëm. Nuk është as i pari e as i fundit Edi Rama që po përdoret në këtë mënyrë. Dhe një gjë tjetër ta keni parasysh: mua nuk më tradhton njeri. Sepse që të më tradhtosh mua, do të thotë që unë të kem bërë një veprim të paligjshëm. Ndërkohë, veprimtaria ime ka qenë gjithmonë aq e ligjshme dhe aq me integritet, sa që nuk ka vend për “tradhtarë”. Që persona të caktuar, të lidhur me mua, kanë bërë veprime të paligjshme sepse kanë menduar që këto gjëra një ditë s’do të dalin, kjo është tjetër gjë. Ata kanë rënë pre e kësaj gjuetie. Sepse, duke mos më gjetur asgjë mua dhe duke hapur rrethin e hetimeve gjithandej, ata janë detyruar të marrin pozicione të pamoralshme, me mendimin që “të shpëtojmë nga përgjegjësia që kemi”. Por kjo nuk ka lidhje me mua, kjo ka lidhje me karakterin e tyre.

Gazetarja: E kuptoj.

Ilir Meta: Pastaj, është një shprehje që e thoshte një analist britanik: në Ballkan, zakonisht, pas një heroi qëndron një tradhtar. Në këtë rast mund të kemi shumë tradhtarë, por kjo vetëm sa tregon fuqinë e heroit.

Gazetarja: Megjithatë, unë nuk mendoj se jeni i vetëm. Unë prapë nuk besoj se jeni i vetëm, zoti Meta.

Ilir Meta: Shiko, këto janë gjëra që ndodhin. Edhe është për të ardhur keq që ne jemi në këtë situatë. Por mos harroni: janë 150 mijë dosje stok. Mos harroni që nuk funksionon sistemi i drejtësisë. Mos harroni që dy të tretat e popullsisë në burgje janë në paraburgim. Ky është një rast

skandaloz. Edhe këta njerëz kanë familje. Unë, për fat të mirë, i kam fëmijët e rritur. Por ata kanë fëmijë nga dy vjeç e katër vjeç, dhe nuk kanë me çfarë t'i mbajnë. Më kupton? Mua këtu nuk më mungon gjë, pavarësisht nga represioni, kufizimet që bëjnë këta. Nuk më mungojnë gjërat e tjera, sepse kam shokët e mi, kolegët e mi, miqtë e mi, të afërmit e mi, që kujdesen për mua. Dhe unë jam shumë më mirë, nga të gjitha parametrat, se ç'kam qenë kur nuk isha këtu.

Gazetarja: Se më thotë, më ngacmon edhe avokati: "Pyete pak për orët, si i kalon tani?" Ne dimë që bëni sport atje. Dimë që Artan Hoxha e thotë herë pas here këtu që jeni bërë kampion në ping-pong, s'po gaboj.

Ilir Meta: Po, ping-pong... s'diskutohet. Por ma kanë ndaluar, ma kanë ndaluar. Dhava një intervistë te kolegja juaj, Beti Njuma, në orën 20:20 të darkës.

Gazetarja: E pashë këtë me shumë kujdes. Ne ishim përgjigjur, por ti kishe zgjedhur atje për t'u përgjigjur. Këtu sot më dhe një përgjigje. Tani si bie, pasi ta mbyllim ne, telefonata do të të dënojnë prapë të mos luash ping-pong, apo jo, Avokat?

Ilir Meta: Dëgjo, nuk i kam problem fare unë këto gjëra. Këto më argëtojnë. Tani nuk jam më në atë fazë që të shqetësohem, të mërzitem.

Gazetarja: Është e vërtetë që kontrollet kryhen më së shumti aty ku je ti? Ka një lloj tendence?

Ilir Meta: Kot, mo, se s'kanë çfarë kontrollojnë. Këta kanë treguar që janë të poshtër edhe me shokët e tyre. Siç ia bënë Erion Velisë: e morën, i futën edhe një telefon, e kapën me përgjime, etj. Mua këto gjëra s'm'i bëjnë dot, se ka një dallim midis meje dhe këtyre. Këta i ka trajnuar *Carsh Megonigali*. Më kupton? Po, Carsh Megonigali duket si peshë e madhe, por ju e dini ku ka përfunduar. Dhe ajo çështje do të rihapet, dhe ne do të luftojmë që të rihapet, sepse është një çështje shumë e madhe dhe do të dalin shumë gjëra të tjera atje. Ndërsa mua më ka trajnuar *Bobi*. Bobi është nivel i lartë, shumë më i lartë. Më kupton? Dhe nuk bëjmë ne gabime të tilla. Këta fusin njerëz për të krijuar prova. Edhe kur dështuan provat e tjera, ato provat imagjinare që kishin dhe kanë akoma në mendjen e tyre, sipas gazetave që publikojnë vetë. Pastaj regjimi thotë: "Mos krijoni ndonjë provë në biruca, me provokatorë, me ndonjë veprim të parregullt, të paligjshëm, etj." Unë i vetmi gabim që bëra ishte që fola me Betin në orën 20:20. Nuk do ta përsëris më këtë.

Gazetarja: Tani thirrjet do jenë... foli në MCN TV, u dënua Ilir Meta. Unë shpresoj shumë jo, por nuk e di si janë rregullat. Sa ju lejohet telefoni?

Ilir Meta: S'kam asnjë shqetësim. Unë këto dënime i quaj dekorata. Jam brenda kohës normale. Ju pashë që po flisnit me avokatin; e lashë avokatin të qetë të shteronte çështjen e zotit Berisha, që e shteroi shumë qartë. Edhe që është një gjë shumë e turpshme: një ish-Kryeministër, ish-President, një udhëheqës i opozitës, por edhe për moshën që ka – pavarësisht se është jashtëzakonisht i ri dhe energjik – t'i formulohet një akuzë nga kongresi i partisë! Dhe ata bëjnë gjithë ato veprime skandaloze mbi bazën e një kallëzimi të rremë.

Avokati Kujtim Çakrani: Edhe ty, kongresi të formuloi.

Ilir Meta: Tani, për kallëzimin e rremë për mua, për atë MK Group... kush mban përgjegjësi? Duhet të mbajë dikush përgjegjësi, apo jo? Nëse kemi shtet serioz.

Gazetarja: Zoti Meta, të bëj një pyetje të fundit: je i keqardhur për opozitën, për numrat, për zgjedhjet që lamë pas?

Ilir Meta: Shiko, unë jam i keqardhur për vendin tim. Për opozitën nuk është se jam shumë i keqardhur, sepse opozita duhet të luftojë më shumë. Opozita duhet të kërkojë më shumë. Kjo është edhe arsyeja pse unë nuk u futa në listat e mbyllura: sepse nuk doja kurrësi, së pari, të tradhetoja bindjet e mia – që listat e mbyllura ishin shkatërrimi i parlamentarizmit në Shqipëri, siç edhe u vërtetua pas 20 vitesh. Së dyti, s'doja t'i jepja asnjë kosto opozitës, që të thoshin të gjithë këta rilindasit e të tjerë: "Po bëhet kjo betejë për të nxjerrë Metën nga burgu." Unë s'e kam këtë shqetësim fare. Unë këtu bëj detoks. Këtu as freskuese nuk përdor, se s'kam asnjë problem me vapën. Me vapën jam shumë miqësor. Problem kam me kondicionerin. Dhe opozita duhet të kishte luftuar shumë më tepër. Duhet të luftojë përditë, dhe jo vetëm disa persona. Nuk duhet të ketë qëndrime të dyzuara për çështje madhore. Dhe opozita nuk duhet të harrojë kurrë që...

Ilir Meta: Reforma në drejtësi u shndërrua në *Ramaform*. Dhe kjo është formuar hap pas hapi, nuk është një gjë që ndodhi sot apo dje. Prandaj e theksova edhe dje në atë intervistë: kjo ka nisur që në janar të vitit 2017. Dhe për këtë gjë unë i kam bërë letër Sekretarit të Shtetit në atë kohë, Rex Tillerson, sepse u përdor një ambasador amerikan për të prishur një proces, i cili, nëse do të kishte ecur siç duhej, Gjykata Kushtetuese do të ishte bërë në kohë, të gjitha organet e drejtësisë do të ishin ngritur në kohë, dhe vendi s'do të kishte mbetur 3 vjet pa Gjykatë Kushtetuese, e kështu me radhë. Por të gjitha këto momente – momenti i zgjedhjes së Prokurores së Përgjithshme me 69 vota, një skandal i madh kundër Kushtetutës; momentet e rënda pastaj të betimeve të gjyqtareve për Gjykatë Kushtetuese të Lana, të noteri, e mbani mend besoj? – të gjitha këto na kanë provuar këtë: *Ramaform*. Pra, nuk është reformë, por Ramaform. Dhe sistemi është *Ramaduro*, siç tha me të drejtë ambasadori Neshel. E kupton? Ky është problemi. Dhe nuk është problem për mua, se unë kam avokatë, kam shokë, kam njerëz kudo, etj. Dhe unë do ta fitoj këtë betejë. Kjo ka përfunduar, sepse jam një njeri që gjithmonë kam respektuar ligjet. Siç e tha edhe avokati: unë sot kam vetëm një të katërtën e apartamentit ku jam rritur, të Pazari i Ri. Kaç, asgjë tjetër. As kam pasur, as dua të kem.

Gazetarja: Unë po të falënderoj, zoti Meta, që i...

Ilir Meta: Po, faleminderit. Edhe i kërkoj falje avokatit se ndoshta i mora pak kohë.

Gazetarja: E kemi të lirë avokatin, do ta ftoj më sërish.

Ilir Meta: Është i paparë, është i paparë avokati. Të përshëndes!

Gazetarja: Faleminderit, zoti Meta.